



# NE I ZGJEDHIM ME VOTA



# ATA NA PËRFAQËSOJNË

## DEMOKRACIA DHE NDARJA E PUSHTETIT

ALBIN (15), ALBIONA (15), PETRIT (15), ARLINDA (14), ERMAL (14), GENTRIT (15), MURAT (15)



### Mësoni më shumë për demokracinë. Mësoni më shumë për historikun e saj dhe për rolin e votës

Ne jemi të lirë dhe jemi të barabartë. Ne shkojmë në shkollë pavarësisht racës, gjinisë, fesë apo gjendjes ekonomike. Zgjedhim udhëheqësit tanë me votën tonë të lirë. Jetojmë në paqe dhe nuk kemi luftë. Prandaj, e duam mënyrën se si jetojmë. Baza e jetesës tonë është demokracia. Pikërisht demokracia ishte edhe tema e grupit tonë këtu në „Demos-ti“. Gjatë diskutimit në grup të vogël, ne kuptuam rolin tonë dhe rëndësinë që ne e kemi në demokraci. Kuptuam se, të gjitha të mirat që i ka demokracia i gëzojmë ne.

Vota jonë është vula e suksesit të shtetit tonë. Ne mendojmë kështu, sepse pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare, kemi të drejtën e votimit. Vota jonë, do të jetë përcaktuese mbi çështjen se kush do ta udhëheqë vendin tonë.


Ashtu sikurse ne që kemi lindur si foshnje e më vonë jemi rritur, kemi ndryshuar dhe jemi pjekur, ashtu ka

ndodhur edhe me demokracinë. Demokracia për herë të parë u paraqit në Athinë. Por, atëherë ishte më ndryshe, sepse të drejtë vote kishin vetëm burrat e pasur. Kurse, sot të gjithë jemi të barabartë në demokraci, sepse demokracia është rritur dhe është zhvilluar. Demokracia ndahet në dy forma: demokracia përfaqësuese dhe e drejtpërdrejtë. Ne në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese, sepse i zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët marrin vendime në emrin tonë. Kurse, në demokracinë e drejtpërdrejtë, populli merr vendimet aty për aty.

Gjithçka që ndodh në vendin tonë e prek jetën tonë. Ne jemi pjesë e shtetit dhe jemi pjesa më e rëndësishme. Ashtu sikurse edhe mushkëritë që kanë nevojë për oksigjen, ashtu edhe demokracia ka nevojë për neve. Andaj, ne do të japim më të mirën tonë që demokracinë ta forcojmë dhe të jetojmë të barabartë dhe në paqe.



Autorët e artikullit duke punuar



Ndarja e pushtetit dhe institucionet përkatëse



Barazia, element bazë i demokracisë



Grupi duke punuar në shkruarjen e artikullit



**Mirë se erdhët në pjesën e dytë të artikullit tonë. Në këtë pjesë do të flasim për ndarjen e pushtetit**

Ndarja e detyrave është diçka që na përcjell në përditshmëri. Për shembull, në një ekip futbolli secili lojtar e ka rolin e vet. Apo më mirë, marrim shembull grupin tonë, ku secili prej nesh ka pasur detyrat e veta. Dikush ka vizatuar, dikush ka shkruar, të tjerët kanë dhënë ide, etj. Ne, këtë ndarje e kemi bërë në mënyrë që puna të lehtësohet dhe jo vetëm njëri të ngarkohet më shumë se tjetri. Ndonëse punët ishin të ndara, ne punuam në mënyrë të barabartë.

E pikërisht kështu ndodh edhe në demokraci, ku pushteti ndahet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv, si dhe Pushteti Gjyqësor. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi. Kuvendi ka për detyrë kryesore miratimin ose mos miratimin e projektligjeve. Ndërkaq, në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeve-

ria, e cila ka për detyrë dërgimin e projektligjeve në Kuvend. Pushteti i fundit është Pushteti Gjyqësor, ku bëjnë pjesë gjykatat. E kur jemi tek gjykatat, në Kosovë kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit si dhe ajo Supreme. Këto gjykata, detyrë kryesore kanë të merren me qytetarët, të cilët dyshohet se ka shkelur ligjin. Ligjet janë rregulla të shkruara shumë të rëndësishme, pa të cilat një vend nuk do të funksiononte. Kjo është njëjtë sikurse në lojërat e ndryshme që luajmë, ku secila lojë i ka rregullat e veta. Prandaj, lojtarët duhet t'u përmbahen atyre rregullave nëse duan që të kenë një lojë të drejtë. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë. Shpresojmë t'iu ketë pëlqyer dhe shpresojmë që këto informata t'i shfrytëzoni në jetën e përditshme.

# KUVENDI - SHTËPIA E POPULLIT

JETLIRË (14), DIELLZA (14), LINDRIT (14), EJDON (15), ARIANIT (15), ARNESA (14), ERLINDA (15)




Funksioni Legjislativ është një ndër funksionet më të rëndësishme që Kuvendi i Kosovës ka, sepse Kuvendi bën miratimin (mos miratimin) e projektligjeve

## Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik dhe ligjvënës në Republikën e Kosovës

Në këtë artikull, ju të dashur lexues do të informoheni më shumë rreth funksioneve dhe rëndësisë së Kuvendit. Si shumë vende të tjera që kanë sistem demokratik të qeverisjes, po ashtu, edhe Kosova e ka këtë sistem. Kuvendi i Kosovës e ushtron Pushtetin Legjislativ si dhe është organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Në Kuvend, kuvendojnë 120 deputetë. Përpos deputetëve në seancat plenare marrin pjesë edhe ministrat dhe Kryeministri. Gjithsej janë 120 deputetë, 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë: romë, ashkali, turk, serb, boshnjak, etj. Kuvendi ka 3 funksione: funksioni kontrollues, sepse Kuvendi mbikëqyr Qeverinë; funksioni

përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë qytetarët e vendit; si dhe funksioni legjislativ, sepse bën miratimin ose mos miratimin e projektligjeve. Kuvendi me votat e deputetëve ka për detyrë ta zgjedh edhe Presidentin e shtetit. Seancat plenare udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit. Mirëpo, nëse Kryetari i Kuvendit nuk është i pranishëm në seancë dhe nuk ka mundësi ta udhëheq atë, atëherë zëvendësohet nga njëri prej nënkryetarëve të tij. Janë 5 nënkryetarë të Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë për detyrë ta zëvendësojnë dhe ta ndihmojnë Kryetarin e Kuvendit në punën e tij. Kuvendi është pjesë e rëndësishme e jetës sonë, sepse ligjet të cilat miratohen në Kuvend, ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë.



Këtu kemi paraqitur disa fakte për Kuvendin



Grupi, i cili me shumë dashuri e shkruajti artikullin

# TË BARABARTË, TË LIRË DHE TË BASHKUAR


ISA (14), ELSA (14), DREN (13), DIELLZA (14), BLEND (14), ENES (13), ALMEDIN (15)

Ne jemi nxënësit nga shkolla „Kadri Zeka“ nga fshati Desivojcë, Kamenicë. Sot, në punëtorinë e demokracisë kemi mësuar për zgjedhjet dhe qytetarinë aktive. Ju lutem, lexojeni artikullin tonë


A dëshironi të dini se çfarë janë zgjedhjet? Zgjedhjet janë mënyrë, përmes së cilës ne bëjmë zgjedhjen e udhëheqësve të vendit tonë. Votimi është e drejtë dhe liri e çdo personi, i cili jeton në një vend demokratik. E drejta e votimit lejohet vetëm mbi moshën 18 vjeçare. Edhe pse ne nuk e kemi arritur këtë moshë, ne prapë kemi votuar në jetën e përditshme, për shembull kur e kemi zgjedhur kryetarin e klasës sonë. Në Kosovë mbahen dy zgjedhje. Ato janë zgjedhjet komunale dhe ato parlamentare. Ne mendojmë se zgjedhjet janë të domosdoshme për shtetin tonë dhe për të gjitha shtetet e tjera. Prandaj, ju ftojmë të gjithëve të dalim dhe të votojmë për ardhmërinë e vendit tonë.



Shkrimtarët dhe piktorët e këtij artikulli



Ne kemi të drejtë të votojmë nga moshë 18 vjeçare



Çdo të thotë të votosh?



Të drejtën e votës e kemi të gjithë, pavarësisht racës



Pjesëmarrja në zgjedhje dhe peticione ka fejtë vlerë!



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Kadri Zeka“  
Klasa: VIII-1 & IX-1  
Vendi: Desivojçë, Kamenicë